



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .8.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

“AKREDITIMIN E VËZHguesve JOPOLITIKË NËPËRMJET PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË VËZHguesve, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR Kryetar TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”.

Në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, akreditimi i vëzhguesve jopartiak do të bëhet edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Vëzhguesve.
2. Të drejtën për të kërkuar akreditimin e vëzhguesve, sipas këtij akti, e kanë subjektet si më poshtë:
 - a. organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin,
 - b. përfaqësuesit e shteteve të huaja,
 - c. media.
3. Procedurat për aplikimin dhe akreditimin e vëzhguesve janë sipas manualit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur është rasti, për të verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e kërkesës për akreditim vëzhguesi, mund të kërkojë të dhëna shtesë nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim.

Datë: .8.2023

Nr.

Ora:



“Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 3 vjet
E. Gaxholli _____
E . Allushi _____
A. Lamçe _____
Y. Merkaj _____

Datë: .8.2023 Nr.
Ora



“Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.